



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

**Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo unutrašnjih poslova - Ministry of Internal Affairs**

---

**Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme,**

Në mbështetje të nenit 54 paragrafi 1 dhe nenit 73 paragrafi 2, nën paragrafi 2.7. të Ligjit Nr. 05/L-022 për Armë (Gazeta Zyrtare Nr. 25, të datës 19.08.2015), nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5. i Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr. 34, 18 nëntor 2022), nenin 8, paragrafin 1.4. të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.04/2021 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2022, si dhe nenin 38, paragrafin 6. të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare, Nr. 15, 12.09.2011),

Nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 03/2023 PËR PROCEDURAT TEKNIKE  
PËR ÇAKTIVIZIMIN E ARMËVE TË KATEGORIVE A, B, C DHE D**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

1. Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe teknikat për çaktivizimin e armëve të kategorive A, B, C dhe D, dhe obligimet që do të ketë personi fizik dhe juridik në lidhje me këto proceduara.

2. Ky Udhëzim Administrativ gjithashtu ka për qëllim që pjesërisht të tranzpozojë:

2.1. Rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2015/2403, të datës 15 dhjetor 2015 për përcaktimin e udhëzimeve të përbashkëta për standardet dhe teknikat e çaktivizimit për të garantuar kthimin në jofunksionale në mënyrë të pakthyeshme të armëve të zjarrit të çaktivizuara; dhe

2.2. Rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2018/337, të datës 5 mars 2018, që ndryshon Rregulloren Zbatuese (BE) 2015/2403 për përcaktimin e udhëzimeve të përbashkëta për

standardet dhe teknikat e çaktivizimit për të garantuar kthimin në jofunksionale në mënyrë të pakthyeshme të armëve të zjarrit të çaktivizuara.

## **Neni 2 Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ janë të detyrueshme për të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët merren me aktivitete dhe çaktivizimin e armëve, sipas Ligjit Nr. 05/L-022 për Armë.

## **Neni 3 Përkufizimet**

1. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ, kanë kuptimet si në vijim:

1.1. **Vërtetim për çaktivizimin e përhershëm të armës** – nënkupton dokumentin e lëshuar nga personi juridik i licencuar për çaktivizim të armës, sipas Ligjit Nr. 05/L-022 për Armë, me të cilin dëshkohet se për armën janë kryer procedura teknike për çaktivizimin e përhershëm të saj;

1.2. **Certifikata e armës së çaktivizuar** - nënkupton dokumentin e lëshuar nga Departamenti për Siguri Publike, me të cilin vërtetohet se arma është çaktivizuar sipas dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.3. **Organ kompetent** – nënkupton Ministria e Punëve të Brendshme;

1.4. **DSP** – nënkupton Departamentin për Siguri Publike, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme;

1.5. **Person juridik** – nënkupton personin juridik i licencuar sipas Ligjit Nr. 05/L-022 për Armë, për çaktivizim të përhershëm të armës;

1.6. **HRC**- Shkalla *Rockwell* është një shkallë fortësie e bazuar në ngurtësinë e dhëmbëzimit të një materiali. Testi *Rockwell* mat thellësinë e depërtimit të një dhëmbëzimi nën një ngarkesë të madhe (ngarkesa kryesore) në krahasim me depërtimin e bërë nga një para ngarkesë (ngarkesa e vogël).

2. Shprehjet, termat dhe shkurtesat tjera të përdorura në këtë Udhëzim Administrativ, kanë kuptimin e njëjtë ashtu siç janë të përkufizuara në Ligjin Nr. 05/L-022 për Armë, si dhe legjislacionin tjetër në fuqi që rregullon këtë fushë.

## **Neni 4 Procedurat për çaktivizimin e armës**

1. Pronari (person fizik ose person përgjegjës i personit juridik) i armës i cili dëshiron ta çaktivizoj armën, duhet që atë ta dërgoj tek personi juridik i licencuar për çaktivizim të përhershëm të armës.

2. Personi juridik i licencuar për çaktivizim të përhershëm të armës, duhet që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të armës, ta çaktivizoj armën.
3. Pas kryerjes së procedurave teknike, sipas paragrafit 2 të këtij neni, i njëjti duhet të lëshoj vërtetim që janë kryer procedurat teknike për çaktivizimin e përhershëm të armës dhe brenda dy (2) ditëve, duhet ta informoj organin kompetent.
4. Zyrtari i përgjegjës nga organi kompetent, në çdo kohë mund ta verifikoj nëse arma është çaktivizuar dhe shënjuar sipas këtij udhëzimi dhe përpilon një raport të veçantë i cili i dërgohet DSP-së.
5. Pronari i armës së çaktivizuar është i detyruar që në afat prej pesë (5) ditëve, t'ia dorëzojë armën dhe vërtetimin stacionit policor.
6. DSP-ja do të vendos lidhur me kërkesën e bërë nga pronari i armës brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh pas parashtrimit të kërkesës, ose në raste të veçanta deri në nëntëdhjetë (90) ditë. Në raste të tilla, DSP-ja obligohet ta informojë palën që ka parashtruar kërkesën për arsyt e rastit të veçantë.
7. Pala e pakënaqur kundër vendimit të DSP-së, ka të drejtë ankese në Komisionin e Ankesave si shkallë e dytë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.
8. Komisioni i Ankesave në afat prej tridhjetë (30) ditësh duhet të vendos lidhur me ankesën nga paragrafi 7 i këtij neni. Vendimi i komisionit të ankesave është i formës përfundimtare.
9. Në rast të aprovimit të kërkesës, DSP-ja do të lëshoj certifikatë se arma është çaktivizuar.

## **Neni 5**

### **Veprimet teknike për çaktivizimin e armëve**

1. Procedurat e çaktivizimit që duhet të kryen për ta bërë armën jofunksionale në mënyrë të përhershme, të pakthyeshme përcaktohen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në tabelat si në vijim:
  - 1.1. Tabela 1- Lista llojeve të ndryshme të armëve;
  - 1.2. Tabela 2 - përcakton parimet e përgjithshme që duhen ndjekur gjatë çaktivizimit të përhershëm të armëve;
  - 1.3. Tabela 3 - përcakton procedurat specifike sipas llojit të armës që duhen kryer për çaktivizim të përhershëm të armës.
2. Tabelat sipas paragrafit 1 të këtij neni, janë pjesë e këtij Udhëzimi Administrativ si Shtojca 1.

**Neni 6**  
**Standardi i shënimit të armëve të çaktivizuara**

1. Të gjitha armët e çaktivizuara në përputhje me procedurat teknike sipas këtij udhëzimi administrativ, duhet të shënjohen.
2. Personi juridik duhet ta vendos shenjën e identifikimit në armën e çaktivizuar e cila përfshinë shkronjat e kodit zyrtar ndërkombëtar të Republikës së Kosovës, vitin e çaktivizimit dhe shenjën D të çaktivizimit.
3. Shënjimi i çaktivizimit do të vendosen në të gjitha pjesët kryesore të tyre.

**Neni 7**  
**Ndalesat dhe masat ndëshkuese**

1. Është i ndaluar riaktivizimi për përdorimin e armës e cila është çaktivizuar më parë.
2. Është i ndaluar eksportimi i armëve të çaktivizuara.
3. Arma e çaktivizuar ndalohet të nxirret nga vendi ku mbahet.
4. Për të gjitha shkeljet e përcaktimeve të këtij Udhëzimi Administrativ, zbatohen masat e parapara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe Ligjit Nr.05/L-022 për Armë.

**Neni 8**  
**Shtojcat**

1. Pjesë përbërëse e këtij udhëzimi administrativ janë edhe shtojcat:
  - 1.1. Shtojca 1- Tabelat;
    - 1.1.1. Shtojca 1.1 - Tabela 1- Lista e llojeve të ndryshme të armëve;
    - 1.1.2. Shtojca 1.2 - Tabela 2 - Parimet përgjithshme që duhen ndjekur gjatë çaktivizimit të përhershëm të armëve;
    - 1.1.3. Shtojca 1.3 - Tabela 3 - Procedurat specifike sipas llojit të armës që duhen kryer për çaktivizim të përhershëm të armës.
  - 1.2. Shtojca 2 - Vërtetim për çaktivizim të armës;
  - 1.3. Shtojca 3 - Certifikata e armës së çaktivizuar.

**Neni 9**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Xhelal SVEÇLA**  
Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme  
106 /2023

**Shtojca 1: TABELAT****Shtojca 1.1. - Tabela 1 - Lista për llojet e ndryshme të armëve:**

1	Pistoleta (me një qitje dhe gjysmë automatike).
2	Revolverë (duke përfshirë revolverët me cilindër mbushës).
3	Armë të gjata me një qitje (pa hapje).
4	Armë të shkurtra dhe të gjata me hapje (pa vjaska, me vjaska, të kombinuara, me mekanizëm të mbylljes së fishekut me ulje poshtë ose me rrotullim ).
5	Armë të gjata me përsëritje (pa vjaska dhe me vjaska).
6	Armë të gjata gjysmë automatike (pa vjaska dhe me vjaska).
7	Armë automatike të shkurtra dhe të gjata.
8	Armë me mbushje nga tyta përfshirë edhe ato me hapje ( përveç revolverëve me mbushje nga cilindri).

**Shtojca 1.2. - Tabela 2: Parimet e përgjithshme që duhen ndjekur gjatë çaktivizimit të përhershëm të armëve**

<b>Nr.</b>	<b>PARIME TË PËRGJITHSHME</b>
1	Personi juridik i licencuar për çaktivizim të përhershëm të armëve, duhet të parandaloj çmontimin e përbërësve thelbësorë të armëve duke salduar, bashkuar (lidhur) ose duke përdorur masat e duhura me shkallën ekuivalente të qëndrueshmërisë.
2	Procesi i çaktivizimit të armëve dhe pjesëve kryesore të tyre do të kryhet pas kontrollit të ushtruar nga DSP.
3	Personi juridik i licencuar për çaktivizim të përhershëm të armëve, duhet të siguroj që materialet që do të përdoren për ngjitje/fiksim të pjesëve dhe mekanizmave të armëve që çaktivizohen (kunjës/tapës/shufrës) duhet të jenë të paktën 40 HRC, ndërsa materiali që përdoret për saldim duhet të siguroj një ngjitje të qëndrueshme.

**Shtojca 1.3. -Tabela 3: Procedurat specifike sipas llojit të armës që duhen kryer për çaktivizimit të përhershëm**

1	Pistoleta (me një qitje dhe gjysmë automatike)
1.1	Tyta: Bëni një prerje gjatësore përgjatë tytës, duke përfshirë edhe folenë, nëse ka (gjerësia: > ½ e kalibrit; gjatësia: për tytat e vjaskuara duhet të jetë sa trefishi i gjatësisë së folesë dhe për ato të pavjaskuara sa dyfishi i gjatësisë së folesë).
1.2	Tyta: Për të gjitha pistoletat e ndryshme nga ato me tytë me hapje, duhet të shpohet një vrimë nëpër dy muret/veshjet e folesë dhe përmes asaj vrime duhet të futet dhe të saldohet në mënyrë të sigurt një kunj i fortë çeliku (me diametër > 50% i diametrit të folesë, min. 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të bllokuar tytën te mekanizmi i mbylljes. Përndryshe, duhet të futet dhe të saldohet mirë në fole një tapë me madhësinë e gëzhgjës.
1.3	Tyta: Hiqni mekanizmin e furnizimit të municioneve, nëse ka.
1.4	Tyta: Tyta duhet të fiksohet në mënyrë të përhershme në armën përmes saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtin nivel qëndrueshmërie. Për këtë qëllim mund të përdoret kunji i përdorur në procedurën 1.2.
1.5	Tyta: Për tytat rezervë që nuk janë të integruara në pistoletë, përdorni sipas rastit procedurat 1.1-1.4 dhe 1.19. Gjithashtu, duhet të parandalohet në mënyrë të përhershme mundësia e montimit të tytave tek armët e përmes prerjes, saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtën shkallë qëndrueshmërie.
1.6	Shuli/koka e shulit: Hiqni ose shkurtoni gjilpërën goditëse.
1.7	Shuli/koka e shulit: Prisni ose hiqni kokën e shulit në një kënd në mes 45 dhe 75 gradë, të matur nga këndi fillestar i kokës. Duhet të hiqet materiali nga e gjithë koka e shulit. Të gjitha kunjat siguroes/ bllokuese duhet të hiqen ose të dobësohen ndjeshëm.
1.8	Shuli/koka e shulit: Saldoni vrimën e gjilpërës goditëse.
1.9	Rrëshqitësi (djepi): Prisni ose hiqni kokën e shulit në një kënd në mes 45 dhe 75 gradë, të matur nga këndi fillestar i kokës. Duhet të hiqet materiali nga e gjithë sipërfaqja.
1.10	Rrëshqitësi (djepi): Hiqni gjilpërën goditëse.
1.11	Rrëshqitësi (djepi): Hiqni kunjat siguroese/ bllokuese që ndodhen te rrëshqitësi.
1.12	Rrëshqitësi (djepi): Nëse është e mundur, hiqni me makineri pjesën e brendshme të skajit bllokues të pikës dalëse që ndodhet te rrëshqitësi, me një kënd 45 deri në 75 gradë.
1.13	Rrëshqitësi (djepi): Nëse është e mundur heqja e shulit nga trupi i rrëshqitësit, shuli i çaktivizuar duhet të montohet në mënyrë të përhershme në trupin e rrëshqitësit.
1.14	Korniza / pranuesi: Hiqni mekanizmin e furnizimit të municioneve, nëse ka.
1.15	Korniza / pranuesi: Hiqni me makineri të paktën 2/3 e shinave të rrëshqitësit, në të dyja anët e kornizës.
1.16	Mekanizmi i shkrepjes: Sigurohuni të shkatërroni lidhjen fizike funksionale në mes këmbëzës dhe çarkut, rrahësit ose shkrehësit. Saldoni mekanizmin e shkrepjes brenda korniza / pranuesi, sipas rastit. Nëse saldimi i tij nuk është i mundur, hiqni mekanizmin e shkrepjes dhe mbusheni hapësirën me saldim ose rezinë epokside.

1.17	Mekanizmi i shkrepjes: Mekanizmi dhe/ose kasa e këmbëzës së shkrepjes duhet të saldohet te korniza / pranuesi (në rastin e kornizës prej çeliku) ose të ngjiten te korniza / pranuesi me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta (në rastin e kornizës prej metalesh të lehta ose prej polimeresh).
1.18	Sistemi automatik: Shkatërroni pistonin e gazeve, tubin e gazeve dhe pikën e daljes së gazeve duke i prerë ose salduar.
1.19	Sistemi automatik: Nëse nuk ka piston gazesh, hiqni tubin e gazeve. Nëse tyta përdoret si piston gazesh, saldoni tytën e çaktivizuar te foleja. Mbyllni daljen e gazeve nga tyta me anë të saldimit, nëse ka një të tillë.
1.20	Karikatori: Saldoni karikatorin/krehrin në disa pika ose përdorni masa të përshtatshme që ofrojnë të njëjtën shkallë qëndrueshmërie, në varësi të llojit të armës dhe të materialit, për të parandaluar heqjen e karikatorit /krehrit.
1.21	Karikatori: Nëse karikatorin/krehrin mungon, saldoni në disa pika ose përdorni masat e përshtatshme në vendin ku qëndron karikatorit/krehri ose vendosni një kyç që do të pengojë në mënyrë të përhershme futjen e karikatorit/krehrit.
1.22	Zhurëmbytësi: Parandaloni në mënyrë të përhershme heqjen e zhurmëmbytësit nga tyta duke përdorur një kunj të fortë çeliku ose me anë të saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtën shkallë qëndrueshmërie, nëse zhurmëmbytësi është i integruar tek arma.
1.23	Zhurëmbytësi: Hiqni të gjitha pjesët e brendshme, kur kjo është e mundur, dhe pikat e lidhjes së zhurmëmbytësit, në mënyrë që të mbetet thjesht një tub. Shponi vrima me diametër më të madh se kalibri i armës dhe në intervale gjatësore prej 3 cm (armët e shkurtra) ose 5 cm (armët e gjata) përmes kasës dhe duke depërtuar në folenë e zgjerimit. Ose përndryshe, bëni një prerje gjatësore prej të paktën 6 mm nga skaji i pasmë deri në atë të përparmë, duke kaluar përmes kasës/mbrojtëses dhe duke depërtuar në folenë e zgjerimit.
<b>2</b>	<b>Revolverë (duke përfshirë revolverët me cilindër mbushës)</b>
2.1	Tyta: Bëni një prerje gjatësore (gjerësia > ½ e kalibrit; gjatësia: minimumi ½ e gjatësisë së tytës nga foleja e futjes së karikatorit).
2.2	Tyta: Duhet të shpohet një vrimë përmes të dyja mureve të tytës (pranë folesë së futjes së karikatorit) dhe përmes saj duhet të futet dhe të saldohet në mënyrë të sigurt një kunj i fortë çeliku (diametri > 50% i kalibrit, min. 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të bllokuar tytën te mekanizmi i mbylljes. Si alternativë, saldoni në mënyrë të sigurt në tytë një tapë bashkuese prej çeliku të temperuar (gjatësia: minimumi sa gjysma e gjatësisë së folesë së cilindrit), duke filluar nga ana ku ndodhet cilindri.
2.3	Tyta: Tyta duhet të montohet në mënyrë të përhershme në kornizë përmes saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtën shkallë qëndrueshmërie. Për këtë qëllim mund të përdoret kunji i përdorur në procedurën 2.2.
2.4	Tyta: Për tytat rezervë që nuk janë të integruara tek arma, përdorni sipas rastit procedurat 2.1-2.3. Gjithashtu, duhet të parandalohet në mënyrë të përhershme mundësia e montimit të tytave tek armët përmes prerjes, saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme me të njëjtën shkallë qëndrueshmërie.



2.5	Cilindri mbushës: Hiqni të gjitha veshjet e brendshme nga cilindri, minimumi sa 2/3 e gjatësisë së tij, me anë të prerjes. Hiqni sa më shumë veshje të brendshme nga cilindri, në kushte ideale sa të arrihet diametri i gëzhojës, pa e çarë veshjen e jashtme.
2.6	Cilindri mbushës: Nëse është e mundur, saldoni kornizën me cilindrin, për të parandaluar heqjen e këtij të fundit, ose merrni masat e duhura që e bëjnë të pamundur heqjen, si p.sh. saldimi i një kunj.
2.7	Cilindri mbushës: Për cilindrin rezervë që nuk janë të montuar në armën e zbatoni procedurën 2.5. Gjithashtu, duhet të parandalohet në mënyrë të përhershme montimi i cilindrit tek armët, përmes prerjes, saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtën shkallë qëndrueshmërie.
2.8	Korniza / pranuesi: Zmadhoni vrimën e gjilpërës goditëse sa trefishi i madhësisë së saj fillestare.
2.9	Korniza / pranuesi : Hiqni ose shkurtoni gjilpërën goditëse.
2.10	Mekanizmi i shkrepjes: Sigurohuni të shkatërmoni lidhjen fizike funksionale midis këmbëzës dhe çarkut, rrahësit ose shkrehësit. Saldoni mekanizmin e shkrepjes brenda kornizës/pranuesit, sipas rastit. Nëse saldimi i tij nuk është i mundur, hiqeni mekanizmin e shkrepjes dhe mbusheni hapësirën me saldim ose rezinë epokside.
2.11	Mekanizmi i shkrepjes: Mekanizmi dhe/ose kasa e këmbëzës së shkrepjes duhet të saldohen te korniza / pranuesi (në rastin e kornizës prej çeliku) ose të ngjiten te korniza / pranuesi me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta (në rastin e kornizës prej metalesh të lehta ose prej polimeresh).
2.12	Zhurëmbytësi: Parandaloni në mënyrë të përhershme heqjen e zhurmëmbytësit nga tyta duke përdorur një kunj të fortë çeliku ose me anë të saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtën shkallë qëndrueshmërie, nëse zhurmëmbytësi është i integruar tek arma.
2.13	Zhurëmbytësi: Hiqni të gjitha pjesët e brendshme, kur kjo është e mundur, dhe pikat e lidhjes së zhurmëmbytësit, në mënyrë që të mbetet thjesht një tub. Shponi vrima me diametër më të madh se kalibri i armës dhe në intervale gjatësore prej 3 cm (armët e shkurtra) ose 5 cm (armët e gjata) përmes kasës dhe duke depërtuar në folenë e zgjerimit. Ose përndryshe, bëni një prerje gjatësore prej të paktën 6 mm nga skaji i pasmë deri në atë të përparmë, duke kaluar përmes kasës/mbrojtëses dhe duke depërtuar në folenë e zgjerimit.
<b>3</b>	<b>Armë të gjata me një qitje (pa hapje)</b>
3.1	Tyta: Bëni një prerje gjatësore përgjatë tytës, duke përfshirë edhe folenë, nëse ka (gjerësia: > ½ e kalibrit; gjatësia: për tytat e vjaskuara duhet të jetë sa trefishi i gjatësisë së folesë dhe për ato të pavjaskuara sa dyfishi i gjatësisë së folesë).
3.2	Tyta: Duhet të shpohet një vrimë nëpër të dyja muret e folesë dhe përmes saj duhet të futet dhe të saldohet në mënyrë të sigurt një kunj i fortë çeliku (diametri > 50% i atij të folesë, min. 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të bllokuar tytën te mekanizmi i mbylljes. Përndryshe, duhet të futet dhe të saldohet mirë në fole një tapë me madhësinë e gëzhojës.
3.3	Tyta: Hiqni mekanizmin e furnizimit të municioneve, nëse ka.
3.4	Tyta: Tyta duhet të fiksohet në mënyrë të përhershme në armën, përmes saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtin nivel qëndrueshmërie. Për këtë qëllim mund të përdoret kunji i përdorur në procedurën 3.2.

3.5	Tyta: Për tytat rezervë që nuk janë të integruara tek arma përdorni sipas rastit procedurat 3.1-3.4. Gjithashtu, duhet të parandalohet në mënyrë të përhershme mundësia e montimit të tytave tek armët, përmes prerjes, saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme me të njëjtën shkallë qëndrueshmërie.
3.6	Shuli/koka e shulit: Hiqni ose shkurtoni gjilpërën goditëse.
3.7	Shuli/koka e shulit: Prisni ose hiqni kokën e shulit në një kënd në mes 45 dhe 75 gradë, të matur nga këndi fillestar i kokës. Duhet të hiqet materiali nga e gjithë koka e shulit. Të gjitha kunjat sigures/ bllokuese duhet të hiqen ose të dobësohen ndjeshëm.
3.8	Shuli/koka e shulit: Saldoni vrimën e gjilpërës goditëse.
3.9	Mekanizmi i shkrepjes: Sigurohuni të shkatërroni lidhjen fizike funksionale midis këmbëzës dhe çarkut, rrahësit ose shkrehësit. Saldoni mekanizmin e shkrepjes brenda kornizës / pranuesit, sipas rastit. Nëse saldimi i tij nuk është i mundur, hiqni mekanizmin e shkrepjes dhe mbusheni hapësirën me saldime ose rezinë epokside.
3.10	Mekanizmi i shkrepjes: Mekanizmi dhe/ose kasa e këmbëzës së shkrepjes duhet të saldohen te korniza / pranuesi (në rastin e kornizës prej çeliku) ose të ngjiten te korniza / pranuesi me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta (në rastin e kornizës prej metalesh të lehta ose prej polimeresh).
3.11	Zhurëmbytësi: Parandaloni në mënyrë të përhershme heqjen e zhurmëmbytësit nga tyta duke përdorur një kunj të fortë çeliku ose me anë të saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtën shkallë qëndrueshmërie, nëse zhurmëmbytësi është i integruar tek arma.
3.12	Zhurëmbytësi: Hiqni të gjitha pjesët e brendshme, kur kjo është e mundur, dhe pikat e lidhjes së zhurmëmbytësit, në mënyrë që të mbetet thjesht një tub. Shponi vrima me diametër më të madh se kalibri i armës dhe në intervale gjatësore prej 3 cm (armët e shkurtra) ose 5 cm (armët e gjata) përmes kasës dhe duke depërtuar në folenë e zgjerimit. Ose përndryshe, bëni një prerje gjatësore prej të paktën 6 mm nga skaji i pasmë deri në atë të përparmë, duke kaluar përmes kasës/mbrojtëses dhe duke depërtuar në folenë e zgjerimit.
<b>4</b>	<b>Armë të shkurtra dhe të gjata me hapje (pa vjaska, me vjaska, të kombinuara, me mekanizëm të mbylljes së fishekut me ulje poshtë ose me rrotullim )</b>
4.1	Tyta: Bëni një prerje gjatësore përgjatë tytës, duke përfshirë edhe folenë, nëse ka (gjerësia: > 1/2 e kalibrit; gjatësia: për tytat e vjaskuara duhet të jetë sa trefishi i gjatësisë së folesë dhe për ato të pavjaskuara sa dyfishi i gjatësisë së folesë). Në rastin e armëve pa fole të integruar në tytë, bëni një prerje gjatësore (gjerësia > 1/2 e kalibrit; gjatësia: minimumi 1/2 e gjatësisë së tytës nga foleja e futjes së karikatorit).
4.2	Tyta: Duhet të saldohet mirë në fole dhe të pozicionohet sa më afër të jetë e mundur me kokën e shulit një tapë që puthitet mirë, me gjatësi të paktën sa 2/3 e gjatësisë së folesë.
4.3	Tyta: Hiqni mekanizmin e furnizimit të municioneve, nëse ka.
4.4	Tyta: Tyta duhet të fiksohet në mënyrë të përhershme në armën përmes saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtin nivel qëndrueshmërie.
4.5	Tyta: Për tytat rezervë që nuk janë të integruara tek arma përdorni sipas rastit procedurat 4.1-4.4. Gjithashtu, duhet të parandalohet në mënyrë të përhershme mundësia e montimit të tytave tek armët përmes prerjes, saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme me të njëjtën shkallë qëndrueshmërie.

4.6	Mekanizmi i shkrepjes: Sigurohuni të shkatërroni lidhjen fizike funksionale në mes këmbëzës dhe çarkut, rrahësit ose shkrehësit. Saldoni mekanizmin e shkrepjes brenda korniza / pranuesi, sipas rastit. Nëse saldimi i tij nuk është i mundur, hiqni mekanizmin e shkrepjes dhe mbushni hapësirën me saldim ose rezinë epokside.
4.7	Mekanizmi i shkrepjes: Mekanizmi dhe/ose kasa e këmbëzës së shkrepjes duhet të saldohen te korniza / pranuesi (në rastin e kornizës prej çeliku) ose të ngjiten te korniza / pranuesi me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta (në rastin e kornizës prej metalesh të lehta ose prej polimeresh).
4.8	Mekanizmi i veprimit: Hapni një vrimë në formë konike me kënd minimal 60 gradë (këndi i kulmit), për të përfutur një diametër bazë prej të paktën 10 mm ose sa diametri i kokës së shulit.
4.9	Mekanizmi i veprimit: Hiqni gjilpërën goditëse, zgjeroni vrimën e gjilpërës derisa të ketë një diametër prej minimumi 5 mm dhe saldoni vrimën e gjilpërës goditëse.
4.10	Zhurëmbytësi: Parandaloni në mënyrë të përhershme heqjen e zhurmëbytësit nga tyta duke përdorur një kunj të fortë çeliku ose me anë të saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtën shkallë qëndrueshmërie, nëse zhurmëbytësi është i integruar tek arma.
4.11	Zhurëmbytësi: Hiqni të gjitha pjesët e brendshme, kur kjo është e mundur dhe pikat e lidhjes së zhurmëbytësit, në mënyrë që të mbetet thjesht një tub. Shponi vrima me diametër më të madh se kalibri i armës dhe në intervale gjatësore prej 3 cm (armët e shkurtra) ose 5 cm (armët e gjata) përmes kasës dhe duke depërtuar në folenë e zgjerimit. Ose përndryshe, bëni një prerje gjatësore prej të paktën 6 mm nga skaji i pasmë deri në atë të përparmë, duke kaluar përmes kasës/mbrojtëses dhe duke depërtuar në folenë e zgjerimit.
<b>5</b>	<b>Armë e gjatë me përsëritje (pa vjaska dhe me vjaska)</b>
5.1	Tyta: Bëni një prerje gjatësore përgjatë tytës, duke përfshirë edhe folenë, nëse ka (gjerësia: > ½ e kalibrit; gjatësia: për tytat e vjaskuara duhet të jetë sa trefishi i gjatësisë së folesë dhe për ato të pavjaskuara sa dyfishi i gjatësisë së folesë). Në rastin e armëve pa fole të integruar në tytë, bëni një prerje gjatësore (gjerësia > ½ e kalibrit; gjatësia: minimumi ½ e gjatësisë së tytës nga foleja e futjes së karikatorit).
5.2	Tyta: Duhet të shpohet një vrimë nëpër të dyja muret e folesë dhe përmes saj duhet të futet dhe të saldohet në mënyrë të sigurt një kunj i fortë çeliku (diametri > 50% i atij të folesë, min. 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të bllokuar tytën te mekanizmi i mbylljes. Përndryshe, duhet të futet dhe të saldohet mirë në fole një tapë me madhësinë e gëzhgjës.
5.3	Tyta: Hiqni mekanizmin e furnizimit të municioneve, nëse ka.
5.4	Tyta: Tyta duhet të fiksohet në mënyrë të përhershme në armën përmes saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtin nivel qëndrueshmërie. Për këtë qëllim mund të përdoret kunji i përdorur në procedurën 5.2.
5.5	Tyta: Për tytat rezervë që nuk janë të integruara tek arma përdorni sipas rastit procedurat 5.1-5.4. Gjithashtu, duhet të parandalohet në mënyrë të përhershme mundësia e montimit të tytave tek armët përmes prerjes, saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme me të njëjtën shkallë qëndrueshmërie.
5.6	Shuli/koka e shulit: Hiqni ose shkurtoni gjilpërën goditëse.

5.7	Shuli/koka e shulit: Prisni ose hiqni kokën e shulit në një kënd midis 45 dhe 75 gradë, të matur nga këndi fillestar i kokës. Duhet të hiqet materiali nga e gjithë koka e shulit. Të gjitha kunjat siguroese/ bllokuese duhet të hiqen ose të dobësohen ndjeshëm.
5.8	Shuli/koka e shulit: Saldoni vrimën e gjilpërës goditëse.
5.9	Mekanizmi i shkrepjes: Sigurohuni të shkatërroni lidhjen fizike funksionale midis këmbëzës dhe çarkut, rrahësit ose shkrehësit. Saldoni mekanizmin e shkrepjes brenda korniza/ pranuesi, sipas rastit. Nëse saldimi i tij nuk është i mundur, hiqni mekanizmin e shkrepjes dhe mbushni hapësirën me saldim ose rezinë epokside.
5.10	Mekanizmi i shkrepjes: Mekanizmi dhe/ose kasa e këmbëzës së shkrepjes duhet të saldohen te korniza/ pranuesi (në rastin e kornizës prej çeliku) ose të ngjiten te korniza/ pranuesi me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta (në rastin e kornizës prej metalesh të lehta ose prej polimeresh).
5.11	Karikatori: Saldoni karikatorin/krehrin në disa pika ose përdorni masa të përshtatshme që ofrojnë të njëjtën shkallë qëndrueshmërie, në varësi të llojit të armës dhe të materialit, për të parandaluar heqjen e karikatorit /krehrit.
5.12	Karikatori: Nëse karikatorin/krehrin mungon, saldoni në disa pika ose përdorni masat e përshtatshme në vendin ku qëndron karikator/krehri ose vendosni një kyç që do të pengojë në mënyrë të përhershme futjen e karikatorit/krehrit.
5.13	Karikatori: Për karikatorët/krehrat në formë gypi, futni një ose disa kunjat të fortë çeliku nëpër karikator/krehër, fole dhe kornizë, duke i lidhur ato në mënyrë të përhershme mes tyre. Më pas saldojini.
5.14	Zhurëmbytësi: Parandaloni në mënyrë të përhershme heqjen e zhurmëmbytësit nga tyta duke përdorur një kunj të fortë çeliku ose me anë të saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtën shkallë qëndrueshmërie, nëse zhurmëmbytësi është i integruar tek arma.
5.15	Zhurëmbytësi: Hiqni të gjitha pjesët e brendshme, kur kjo është e mundur, dhe pikat e lidhjes së zhurmëmbytësit, në mënyrë që të mbetet thjesht një tub. Shponi vrima me diametër më të madh se kalibri i armës dhe në intervale gjatësore prej 3 cm (armët e shkurtra) ose 5 cm (armët e gjata) përmes kasës dhe duke depërtuar në folenë e zgjerimit. Ose përndryshe, bëni një prerje gjatësore prej të paktën 6 mm nga skaji i pasmë deri në atë të përparmë, duke kaluar përmes kasës/mbrojtëses dhe duke depërtuar në folenë e zgjerimit.
<b>6</b>	<b>Armë e gjatë me përsëritje (pa vjaska dhe me vjaska)</b>
6.1	Tyta: Bëni një prerje gjatësore përgjatë tytës, duke përfshirë edhe folenë, nëse ka (gjerësia: > ½ e kalibrit; gjatësia: për tytat e vjaskuara duhet të jetë sa trefishi i gjatësisë së folesë dhe për ato të pavjaskuara sa dyfishi i gjatësisë së folesë). Në rastin e armëve pa fole të integruar në tytë, bëni një prerje gjatësore (gjerësia > ½ e kalibrit; gjatësia: minimumi ½ e gjatësisë së tytës nga foleja e futjes së karikatorit).
6.2	Tyta: Duhet të shpohet një vrimë nëpër të dyja muret e folesë dhe përmes saj duhet të futet dhe të saldohet në mënyrë të sigurt një kunj i fortë çeliku (diametri > 50% i atij të folesë, min. 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të bllokuar tytën te mekanizmi i mbylljes. Përndryshe, duhet të futet dhe të saldohet mirë në fole një tapë me madhësinë e gëzhojës.
6.3	Tyta: Hiqni mekanizmin e furnizimit të municioneve, nëse ka.
6.4	Tyta: Tyta duhet të fiksohet në mënyrë të përhershme në armën, përmes saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtin nivel qëndrueshmërie. Për këtë qëllim mund të përdoret kunji i përdorur në procedurën 6.2.

6.5	Tyta: Për tytat rezervë që nuk janë të integruara tek arma përdorni sipas rastit procedurat 6.1-6.4 dhe 6.12. Gjithashtu, duhet të parandalohet në mënyrë të përhershme mundësia e montimit të tytave tek armët përmes prerjes, saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme me të njëjtën shkallë qëndrueshmërie.
6.6	Shuli/koka e shulit: Hiqni ose shkurtoni gjilpërën goditëse.
6.7	Shuli/koka e shulit: Prisni ose hiqni kokën e shulit në një kënd midis 45 dhe 75 gradë, të matur nga këndi fillestar i kokës. Duhet të hiqet materiali nga e gjithë koka e shulit. Të gjitha kunjat sigures/ bllokuese duhet të hiqen ose të dobësohen ndjeshëm.
6.8	Shuli/koka e shulit: Saldoni vrimën e gjilpërës goditëse.
6.9	Mekanizmi i shkrepjes: Sigurohuni të shkatërroni lidhjen fizike funksionale midis këmbëzës dhe çarkut, rrahësit ose shkrehësit. Saldoni mekanizmin e shkrepjes brenda korniza/ pranuesi, sipas rastit. Nëse saldimi i tij nuk është i mundur, hiqni mekanizmin e shkrepjes dhe mbushni hapësirën me saldim ose rezinë epokside.
6.10	Mekanizmi i shkrepjes: Mekanizmi dhe/ose kasa e këmbëzës së shkrepjes duhet të saldohen te korniza/ pranuesi (në rastin e kornizës prej çeliku) ose të ngjiten te korniza/ pranuesi me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta (në rastin e kornizës prej metalesh të lehta ose prej polimeresh).
6.11	Sistemi automatik: Shkatërroni pistonin e gazeve, tubin e gazeve dhe pikën e daljes së gazeve duke i prerë ose salduar.
6.12	Sistemi automatik: Nëse nuk ka piston gazesh, hiqni tubin e gazeve. Nëse tyta përdoret si piston gazesh, saldoni tytën e çaktivizuar te foleja. Mbyllni daljen e gazeve nga tyta me anë të saldimit, nëse ka një të tillë.
6.13	Sistemi automatik: Prisni ose hiqni kokën e shulit në një kënd në mes 45 dhe 75 gradë, të matur nga këndi fillestar i kokës. Duhet të hiqet materiali nga e gjithë sipërfaqja e kokës së shulit dhe nga çdo hapësirë tjetër në mënyrë që foleja e fishekut/shuli të reduktohet me minimumi 50% të peshës fillestare. Fiksoni shulin në mënyrë të përhershme në armën përmes saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtën shkallë qëndrueshmërie.
6.14	Sistemi automatik: Në rastet kur kokat e shulit janë të integruara në një mbajtëse shuli, mbajtësja duhet të reduktohet me minimumi 50%. Koka e shulit duhet të montohet në mënyrë të përhershme te mbajtësja dhe kjo e fundit duhet të montohet në mënyrë të përhershme tek arma nëpërmjet saldimit, lidhjes/bashkimit ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtën shkallë qëndrueshmërie.
6.15	Karikatori: Saldoni karikatorin/krehrin në disa pika ose përdorni masa të përshtatshme që ofrojnë të njëjtën shkallë qëndrueshmërie, në varësi të llojit të armës dhe të materialit, për të parandaluar heqjen e karikatorit /krehrit.
6.16	Karikatori: Nëse karikator/krehri mungon, saldoni në disa pika ose përdorni masat e përshtatshme në vendin ku qëndron karikator/krehri ose vendosni një kyç që do të pengojë në mënyrë të përhershme futjen e karikatorit/krehrit.
6.17	Karikatori: Për karikatorin/krehrat në formë gypi, futni një ose disa kunjat të fortë çeliku nëpër karikator/krehër, fole dhe kornizë, duke i lidhur ato në mënyrë të përhershme mes tyre. Më pas saldojini.
6.18	Zhurëmbytësi: Parandaloni në mënyrë të përhershme heqjen e zhurmëmbytësit nga tyta duke përdorur një kunj të fortë çeliku ose me anë të saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtën shkallë qëndrueshmërie, nëse zhurmëmbytësi është i integruar tek arma.

6.19	Zhurmembytësi: Hiqni të gjitha pjesët e brendshme, kur kjo është e mundur, dhe pikat e lidhjes së zhurmëmbytësit, në mënyrë që të mbetet thjesht një tub. Shponi vrima me diametër më të madh se kalibri i armës dhe në intervale gjatësore prej 3 cm (armët e shkurtra) ose 5 cm (armët e gjata) përmes kasës dhe duke depërtuar në folenë e zgjerimit. Ose përndryshe, bëni një prerje gjatësore prej të paktën 6 mm nga skaji i pasmë deri në atë të përparmë, duke kaluar përmes kasës/mbrojtëses dhe duke depërtuar në folenë e zgjerimit.
<b>7</b>	<b>Armë automatike të shkurtra dhe të gjata</b>
7.1	Tyta: Bëni një prerje gjatësore përgjatë tytës, duke përfshirë edhe folenë, nëse ka (gjerësia: > ½ e kalibrit; gjatësia: për tytat e vjaskuara duhet të jetë sa trefishi i gjatësisë së folesë dhe për ato të pavjaskuara sa dyfishi i gjatësisë së folesë).
7.2	Tyta: Duhet të shpohet një vrimë nëpër të dyja muret e folesë dhe përmes saj duhet të futet dhe të saldohet në mënyrë të sigurt një kunj i fortë çeliku (diametri > 50% i atij të folesë, min. 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të bllokuar tytën te mekanizmi i mbylljes. Përndryshe, duhet të futet dhe të saldohet mirë në fole një tapë me madhësinë e gëzhgjës.
7.3	Tyta: Hiqni mekanizmin e furnizimit të municioneve, nëse ka.
7.4	Tyta: Tyta duhet të fiksohet në mënyrë të përhershme në armën përmes saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtin nivel qëndrueshmërie. Për këtë qëllim mund të përdoret kunji i përdorur në procedurën 7.2.
7.5	Tyta: Për tytat rezervë që nuk janë të integruara tek arma përdorni sipas rastit procedurat 7.1-7.3. Gjithashtu, duhet të parandalohet në mënyrë të përhershme mundësia e montimit të tytave tek armët përmes prerjes, saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme me të njëjtën shkallë qëndrueshmërie.
7.6	Shuli/koka e shulit: Hiqni ose shkurtoni gjilpërën goditëse.
7.7	Shuli/koka e shulit: Prisni ose hiqni kokën e shulit në një kënd në mes 45 dhe 75 gradë, të matur nga këndi fillestar i kokës. Duhet të hiqet materiali nga e gjithë koka e shulit. Të gjitha kunjat sigures/ bllokuese duhet të hiqen ose të dobësohen ndjeshëm.
7.8	Shuli/koka e shulit: Saldoni vrimën e gjilpërës goditëse.
7.9	Rrëshqitësi (për pistoletat automatike): Prisni ose hiqni kokën e shulit në një kënd midis 45 dhe 75 gradë, të matur nga këndi fillestar i kokës. Duhet të hiqet materiali nga e gjithë sipërfaqja.
7.10	Rrëshqitësi (për pistoletat automatike): Hiqni gjilpërën goditëse.
7.11	Rrëshqitësi (për pistoletat automatike): Hiqni kunjat sigures/ bllokuese që ndodhen te rrëshqitësi.
7.12	Rrëshqitësi (për pistoletat automatike): Nëse është e mundur, hiqni me makineri pjesën e brendshme të skajit bllokues të pikës dalëse që ndodhet te rrëshqitësi, me një kënd 45 deri në 75 gradë.
7.13	Rrëshqitësi (për pistoletat automatike): Nëse është e mundur heqja e shulit nga trupi i rrëshqitësit, shuli i çaktivizuar duhet të montohet në mënyrë të përhershme në trupin e rrëshqitësit.
7.14	Korniza/ pranuesi (për pistoletat automatike): Hiqni mekanizmin e furnizimit të municioneve, nëse ka.
7.15	Korniza/ pranuesi (për pistoletat automatike): Hiqni me makineri të paktën 2/3 e shinave të rrëshqitësit, në të dyja anët e kornizës.

7.16	Mekanizmi i shkrepjes: Sigurohuni të shkatërroni lidhjen fizike funksionale midis këmbëzës dhe çarkut, rrahësit ose shkrehësit. Saldoni mekanizmin e shkrepjes brenda korniza/ pranuesi, sipas rastit. Nëse saldimi i tij nuk është i mundur, hiqni mekanizmin e shkrepjes dhe mbushni hapësirën me saldim ose rezinë epokside.
7.17	Mekanizmi i shkrepjes: Mekanizmi dhe/ose kasa e këmbëzës së shkrepjes duhet të saldohen te korniza/ pranuesi (në rastin e kornizës prej çeliku) ose të ngjiten te korniza/ pranuesi me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta (në rastin e kornizës prej metalesh të lehta ose prej polimeresh).
7.18	Sistemi automatik: Shkatërroni pistonin e gazeve, tubin e gazeve dhe pikën e daljes së gazeve duke i prerë ose salduar.
7.19	Sistemi automatik: Nëse nuk ka piston gazesh, hiqni tubin e gazeve. Nëse tyta përdoret si piston gazesh, saldoni tytën e çaktivizuar te foleja. Mbyllni daljen e gazeve nga tyta me anë të saldimit, nëse ka një të tillë.
7.20	Sistemi automatik: Prisni ose hiqni kokën e shulit në një kënd në mes 45 dhe 75 gradë, të matur nga këndi fillestar i kokës. Duhet të hiqet materiali nga e gjithë sipërfaqja e kokës së shulit dhe nga çdo hapësirë tjetër në mënyrë që foleja e fishekut/shuli të reduktohet me minimumi 50% të peshës fillestare. Fiksoni shulin në mënyrë të përhershme në armën përmes saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtën shkallë qëndrueshmërie.
7.21	Sistemi automatik: Në rastet kur kokat e shulit janë të integruara në një mbajtëse shuli, mbajtësja duhet të reduktohet me minimumi 50%. Koka e shulit duhet të montohet në mënyrë të përhershme te mbajtësja dhe kjo e fundit duhet të montohet në mënyrë të përhershme tek arma nëpërmjet saldimit, lidhjes/bashkimit ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtën shkallë qëndrueshmërie.
7.22	Karikatori: Saldoni karikatorin/krehrin në disa pika ose përdorni masa të përshtatshme që ofrojnë të njëjtën shkallë qëndrueshmërie, në varësi të llojit të armës dhe të materialit, për të parandaluar heqjen e karikatorit /krehrit.
7.23	Karikatori: Nëse karikator/krehri mungon, saldoni në disa pika ose përdorni masat e përshtatshme në vendin ku qëndron karikator/krehri ose vendosni një kyç që do të pengojë në mënyrë të përhershme futjen e karikatorit/krehrit.
7.24	Karikatori: Për karikatorin/krehrat në formë gypi, futni një ose disa kunjat të fortë çeliku nëpër karikator/krehër, fole dhe kornizë, duke i lidhur ato në mënyrë të përhershme mes tyre. Më pas saldojini.
7.25	Zhurëmbytësi: Parandaloni në mënyrë të përhershme heqjen e zhurmëbytësit nga tyta duke përdorur një kunj të fortë çeliku ose me anë të saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme që ofrojnë të njëjtën shkallë qëndrueshmërie, nëse zhurmëbytësi është i integruar tek arma.
7.26	Zhurëmbytësi: Hiqni të gjitha pjesët e brendshme, kur kjo është e mundur, dhe pikat e lidhjes së zhurmëbytësit, në mënyrë që të mbetet thjesht një tub. Shponi vrima me diametër më të madh se kalibri i armës dhe në intervale gjatësore prej 3 cm (armët e shkurtra) ose 5 cm (armët e gjata) përmes kasës dhe duke depërtuar në folenë e zgjerimit. Ose përndryshe, bëni një prerje gjatësore prej të paktën 6 mm nga skaji i pasmë deri në atë të përparmë, duke kaluar përmes kasës/mbrojtëses dhe duke depërtuar në folenë e zgjerimit.
<b>8</b>	<b>Armë me mbushje nga tyta përfshirë edhe ato me hapje ( përveç revolverëve me mbushje nga cilindri)</b>

8.1	Tyta: Bëni një prerje gjatësore përgjatë tytës, duke përfshirë edhe dhomën e djegies, nëse ka (gjerësia: $> \frac{1}{2}$ e kalibrit; gjatësia: e barabartë me trefishin e diametrit të plumbit). Për armët pa dhomë djegieje të integruar në tytë, bëni një prerje gjatësore (gjerësia $> \frac{1}{2}$ e kalibrit; gjatësia: minimumi $\frac{1}{2}$ e gjatësisë së tytës nga foleja e futjes së karikatorit).
8.2	Tyta: Në rastin e armëve me dhomë djegieje të integruar te tyta, duhet të shpohet një vrimë përgjatë të dyja pareteve të dhomës dhe përmes asaj vrimë duhet të futet dhe të saldohet në mënyrë të sigurt një kunj i fortë çeliku (diametri $> 50\%$ i atij të folesë, min. 4,5 mm). I njëjti kunj mund të përdoret për të bllokuar tytën te mekanizmi i mbylljes. Në rastin e armëve pa dhomë djegieje të integruar në tytë, saldoni mirë një tapë prej çeliku të temperuar (gjatësia: minimumi dyfishi i gjatësisë së diametrit të plumbit) në tytë, duke nisur nga foleja e futjes së karikatorit.
8.3	Tyta: Për tytat rezervë që nuk janë të integruara tek arma përdorni sipas rastit procedurat 8.1-8.2. Gjithashtu, duhet të parandalohet në mënyrë të përhershme mundësia e montimit të tytave tek armët përmes prerjes, saldimit, lidhjes ose përdorimit të masave të përshtatshme me të njëjtën shkallë qëndrueshmërie.
8.4	Në rastin e armëve me hapje: Hapni një vrimë në formë konike me kënd minimal 60 gradë (këndi i kulmit), për të përfutur një diametër bazë prej të paktën 10 mm ose sa diametri i kokës së shulit.
8.5	Në rastin e armëve me hapje: Hiqni gjilpërën goditëse, zgjeroni vrimën e gjilpërës derisa të ketë një diametër prej minimumi 5 mm dhe saldoni vrimën e gjilpërës goditëse.
8.6	Mekanizmi i shkrepjes: Sigurohuni të shkatërroni lidhjen fizike funksionale në mes këmbëzës dhe çarkut, rrahësit ose shkrehësit. Saldoni mekanizmin e shkrepjes brenda korniza/ pranuesi, sipas rastit. Nëse saldimi i tij nuk është i mundur, hiqni mekanizmin e shkrepjes dhe mbushni hapësirën me saldim ose rezinë epokside.
8.7	Mekanizmi i shkrepjes: Mekanizmi dhe/ose kasa e këmbëzës së shkrepjes duhet të saldohet te korniza/ pranuesi (në rastin e kornizës prej çeliku) ose të ngjiten te korniza/ pranuesi me ngjitës rezistent ndaj temperaturave të larta (në rastin e kornizës prej metalesh të lehta ose prej polimeresh).
8.8	Thumbat/vrimat: Hiqni ose saldoni thumbat, saldoni vrimat.
8.9	Dhoma djegieje të veçanta ose të shumëfishta (përveç cilindrit): Në rastin e armëve me dhoma djegieje të veçanta ose të shumëfishta, prisni dhe hiqni muret e brendshme të dhomë/ave të djegies deri në minimum $\frac{2}{3}$ e gjatësisë së tyre. Hiqni sa më shumë mure të brendshme që të jetë e mundur, në mënyrë ideale deri në diametrin e kalibrit.



Logoja e personit juridik të licencuar  
Logo of the licensed legal entity  
Logo licenciranog pravnog lica

Emri i personit juridik të licencuar:  
Name of the licensed legal entity:  
Naziv licenciranog pravnog lica:

Numri i dokumentit/Broj dokumenta / Document Number:

Data/ Daum /Date:

**VËRTETIM PËR ÇAKTIVIZIM TË ARMËS**  
**FIREARM DEACTIVATION ATTESTATION**  
**POTVRDA O DEAKTIVIRANJU ORUŽJA**

Nr. i biznesit Br. poslovanja No. of entity	
Adresa Adresa Address	
Nr. i licencës Br. licence Licence No	

Konfirmon që arma në vijim është çaktivizuar  
Potvrđuje da sledeće vatreno oružje prošlo je probno pucanje  
Confirms that the following firearm has been deactivated.

ARMA/ ORUŽJE/ WEAPON	
Emri i prodhuesit Ime proizvođača Producer name	
Vendi i prodhimit Zemlja proizvodnje Country of production	
Lloji Vrsta Type	
Prodhimi Marka Brand	
Modeli Model Model	
Numri serik Seriski broj Serial number	
Kalibri/ Kalibar / Caliber	

Personi përgjegjës Odgovorno lice Name of the responsible person		Vula /Pecat/ Stamp
Pozita Pozicija Title		
Nënshkrimi Potpis Signature		



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government

Organi kompetent/ Nadležni Organ /Competent Body/:

Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo unutrašnjih poslova  
Ministry of Internal Affairs

Numri i dokumentit/Broj dokumenta / Document Number:  
Data/ Datum /Date:

**CERTIFIKATA E ARMËS SË ÇAKTIVIZUAR**  
**DEACTIVATED FIREARM CERTIFICATE**  
**UVERENJE DEAKTIVIRANOG ORUŽJA**

Konfirmon që arma në vijim është çaktivizuar sipas Ligjit për Armë Nr. 05/L-022 dhe sipas Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr. 03/2023 për Procedurat Teknike për Çaktivizimin e Armëve të Kategorive A, B, C dhe D.

Certifies that that the following firearm has been deactivated pursuant to Law No. 05/L-022 On Weapons and pursuant to the Administrative Instruction (MIA) No. 03/2023 on the Technical Procedures for Deactivating Weapons of Categories A, B, C and D

Potvrđuje da je sledeće oružje deaktivirano u skladu sa Zakonom o oružju br. 05/L-022, i skladu sa Administrativnim uputstvom (MUP) br. 03/2023 o tehničkim postupcima za deaktiviranje oružja kategorija A, B, C i D

ARMA/ ORUŽJE/ FIREARM	
Emri i prodhuesit Ime proizvođača Manufacturer's name	
Vendi i prodhimit Zemlja proizvodnje Country of Production	
Lloji Vrsta Type	
Prodhimi Marka Brand	
Modeli Model Model	
Numri serik Serijski broj Serial number	
Kalibri/ Kalibar/Caliber	
Personi përgjegjës Odgovorno lice Name of the responsible person	<u>Vula /Pecat/ Stamp</u>
Pozita Pozicija Title	
Nënshkrimi Potpis Signature	

**Vërejtje:** Kjo certifikatë duhet të mbahet nga pronari i armës së çaktivizuar në çdo kohë!

**Remarks:** This certificate must be kept by the owner of the deactivated firearm at all times!

**Napomena:** Ovo uverenje vlasnik deaktiviranog oružja treba stalno čuvati!